

# Obligimet nga ‘Procesi i Berlinit’ për Sundim të Ligjit dhe Mirëqeverisje

PËRGATITJA PËR AGJENDËN “BERLIN PLUS”

**Obligimet nga ‘Procesi i Berlinit’  
për Sundim të Ligjit dhe Mirëqeverisje**

**PËRGATITJA PËR AGJENDËN “BERLIN PLUS”**

Përgatitur nga:  
Democracy Plus

*Qëndrimet e paraqitura në këtë punim nuk paraqesin qëndrimet e Fondacionit Konrad Adenauer.*

Dhjetor, 2019

Prishtinë

## **PËRMBAJTJA**

<b>HYRJE.....</b>	<b>3</b>
<b>PSE AGJENDA 'BERLIN PLUS' PËR KOSOVËN .....</b>	<b>4</b>
Në Hap me vendet e Rajonit.....	4
Projektet Infrastrukturore të Konektivitetit .....	5
Iniciativa “Schengeni Ballkanik” .....	6
<b>TEMATIKAT NË PROCESIN E BERLINIT .....</b>	<b>7</b>
<b>SUNDIMI I LIGJIT DHE MIRËQEVERISJA .....</b>	<b>8</b>
Berlin 2014.....	8
Vjena 2015 .....	8
Paris 2016.....	9
Triestë 2017.....	9
Londër 2018 .....	10
Poznan 2019.....	10
Roli i Forumi të Shoqërisë Civile.....	11
<b>Zotimet e Qeverisë së Kosovës Anti-Korrupsion .....</b>	<b>12</b>
Ekspozimin e korrupsionit.....	13
Prokurimi publik dhe kontraktimi i hapur .....	13
Taksat.....	13
Sinjalizuesit .....	13
Pronësia përfituese.....	14
Ndëshkimin e të korruptuarve .....	14
Riparimi i pasurisë dhe kthimi i pasurive .....	14
Dëbimin e kulturës së korrupsionit.....	14
Integriteti institucional.....	14
Edukimi kundër korrupsionit .....	14
<b>OBLIGIMET TJERA TË KOSOVËS NË PROCES .....</b>	<b>15</b>
Bashkëpunimi rajonal dhe Pajtimi.....	15
Agjenda e Konektivitetit (transporti dhe energjia) .....	16
<b>REKOMANDIMET PËR QEVERINË E RE .....</b>	<b>20</b>

## HYRJE

Të qenit pjesë e Bashkimit Evropian nuk është e drejtë që patjetër duhet t'i ipet një vendi gjeografikisht të lidhur me kontinentin e Evropës. Por anëtarësimi në Bashkim Evropian është një mundësi që i'u ofrohet vendeve të Ballkanit Perëndimor të cilat janë të rrethuara në të katër anët me Bashkim Evropian. Mundësia për anëtarësim duhet të fitohet me vullnet politik dhe përkushtim në përafrimin e standardeve të larta evropiane. Kjo bëhet duke patur seriozitet në përmbushjen e obligimeve që merren në këtë proces tejet të rëndësishëm për të ardhmen e Kosovës. Është e vërtetë që disa vendime të fundit të Bashkimit Evropian karshi disa vendeve të Ballkanit Perëndimor kanë qenë dekurajuese për të gjithë rajonin. Mirëpo, kur ndodh një hap prapa në këtë proces nuk është arsye që të hiqet vëmendja nga rrugëtimi. I ashtuquajtimi "Proces i Berlinit" i cili filloi me Samitin në Berlin me 2014 ku pjesëmarrëse ishin udhëheqësit më të lartë të 10 shteteve të BE-së dhe gjashtë shteteve të Ballkanit Perëndimor, përfshirë Kosovën, ishte një përpjekje serioze që vendet e rajonit tonë të përgatiten, si rajon, për anëtarësim në momentin kur të piqen kushtet.

Pas një përkushtimi të madh të shtetit nikoqir, Gjermanisë dhe Kancelares së Gjermanisë, Angela Merkel, Samiti i Berlinit për Ballkanin Perëndimor në 2014 e përmbylli punën me tri zotime të përbashkëta të cilat janë kthyer në shtylla të agjendës së 'Procesit të Berlinit'. Në mesin e zotimeve për intensifikimi të bashkëpunimit rajonal në Ballkan Perëndimor dhe rritjes së prosperitetit përmes zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm, ishte edhe zotimi për fuqizimin e qeverisjes së mirë. Në Deklaratën Përfundimtare të Samitit, zotimi kishte dy elemente kryesore: fuqizimin e sundimit të ligjit dhe përmirësimin e qeverisjes së mirë. Pra qeverisja e mirë duke përfshirë këtu sundimin e ligjit u konfirmua si shtyllë kyçe e përafrimit të Bashkimit Evropian.

Samiti me 2014 është pasuar me Samite të tilla për çdo vit. Edhe pse në Berlin, vendet pjesëmarrëse i dhanë vetit një mandat katër vjeçar për këtë proces, këtë vit Samiti në Poznan për vendet e Ballkanit Perëndimor ishte vazhdimësi e këtij procesi i cili filloi të njihet si Agjenda "Berlin Plus". Ky proces po vazhdohet për të përkrahur edhe më tutje rajonin tonë që të përgatitet për anëtarësim në BE por edhe për arsye se zotimet e marra që nga Samiti i parë kanë mjaft punë për t'u përmbushur, edhe pse ka patur disa arritje konkrete nga vende të ndryshme të rajonit tonë.

Gjatë këtyre samiteve janë dhënë zotime të shumta nga krerët e vendeve të Ballkanit Perëndimor të cilat kanë shkuar përtej tri zotimeve të para. Obligimet për sundim të ligjit dhe qeverisje të mirë janë përcjell në gati secilin samit, mirëpo ka patur edhe zgjerim të fushave ku janë përfshirë edhe tema të reja varësisht prej aktualitetit. Në këtë drejtim, shtetet e Ballkanit Perëndimor janë deklaruar për të përmbushur obligime nga fusha e bashkëpunimit rajonal, qeverisjes së mirë, zhvillimit ekonomik, luftës kundër ekstremizmit dhe radikalizmit, migrimin, rinisë, dhe konektivitetin në mes veti përmes transportit dhe energjisë.

Ky studim përqendrohet në obligimet e rajonit, dhe konkretisht Kosovës, për fushën e sundimit të ligjit dhe mirëqeverisjes. Kosova do të ballafaqohet në Samitet e agjendës "Berlin Plus" me udhëheqësit e vendeve të Bashkimit Evropian. Gjëja që do të jetë në mendjen e secilit udhëheqës evropian është se çfarë ka bërë Kosova dhe secili vend i Ballkanit Perëndimor për obligimet që ka marrë në Procesin e Berlinit që nga 2014-ta. Më tutje, ata me

siguri do të pyesin veten dhe vendet e rajonit tonë, në mënyrë diplomatike, se çfarë është bërë në fushat më sfiduese për liderët ballkanik, si sundimi i ligjit dhe qeverisja e mirë.

Kosova ka përfituar shumë nga procesi i Berlinit dhe ka qenë partner i barabartë me shtetet tjera të rajonit. Ka përfituar shumë edhe nga projektet infrastrukturore të konektivitetit për të cilat janë ndarë qindra miliona nga Bashkimi Evropian në kuadër të këtij procesi. Por shpesh nga udhëheqësit tanë, por edhe nga publiku i gjerë, ky proces është parë më shumë si një proces që ofron investime dhe janë lënë paksa nën hije përkushtimi për përmbushje të obligimeve të marra në këtë proces. Qeveria e re e Kosovës duhet t'i jep një shtytje të re përmbushjes së obligimeve të marrura në këtë proces sepse më së shumti Kosovës, nga i gjithë rajoni, i konvenon që ky proces i nisur në Berlin të vazhdoj.

## PSE AGJENDA 'BERLIN PLUS' PËR KOSOVËN

“Katër vjet progres të vërtetë” ishte thirrja e Deklaratës Përfundimtare të Konferencës për Ballkanin Perëndimor në Berlin. Pra ky proces i dha vetit mandat katër-vjeçar dhe qëllimi ishte që gjatë këtyre katër viteve të ketë dinamikë të shtuar të bashkëpunimit rajonal, sundimit të ligjit dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Samiti i Londrës në vitin 2018 ishte planifikuar të ishte i fundit. Megjithatë, Ministri i Punëve të Jashtme të Gjermanisë, Z. Sigmar Gabriel, në maj të vitit 2017 vetëm kishte paralajmëruar vazhdimin e Procesit të Berlinit, apo “Agjendën Berlin Plus” si u quajt<sup>1</sup>. Dhe kjo vetëm se ka filluar të jetësohet me Samitin e Poznanit në 2019 dhe Samitin e pritshëm në 2020 të paralajmëruar në Kroaci.

Gjatë këtij katër vjeçari kishte edhe thirrje nga ekspertë të Ballkanit Perëndimor që të hiqet dorë nga ky proces për shkak të seriozitetit jo të duhur të vendeve kyçe të Bashkimit Evropian<sup>2</sup>. Më tutje, mund të ketë edhe argumente tjera se ky proces duhet të ndërpritet sepse nuk ka arritur sukses të mjaftueshëm nga ana e vendeve të Ballkanit Perëndimor. Megjithatë, përfitimet, sidomos nga Kosova, në vazhdimin e Procesit të Berlinit apo “Berlin Plus” janë të shumëfishta, përkundër disa ngecjeve dhe kritikave të procesit. Kosova duhet të përgatitet për këtë proces dhe më së shumti duhet të insistoj në këtë proces për disa arsye kyçe.

### Në hap me vendet e rajonit

Përmbyllja e Procesit të Berlinit më së paku i konvenon Kosovës. Kosova përfiton më së shumti se gjitha vendet e rajonit nga një proces që synon t'i vendos gjitha këto shtete në një proces të integritimit evropian. ‘Procesi i Berlinit’ është proces i integritimit evropian. Është proces që e trajton gjithë rajonin si një grup në përafrim të Bashkimit Evropian.

Në këtë udhëtim drejt Bashkimit Evropian, Kosova është më prapa se gjitha vendet e rajonit tonë. Po ashtu, për arsye të mos njohjes së shtetësisë së Kosovës nga pesë vende të BE-së, BE ka treguar se ka prireje ta vlerësoj më padrejtë Kosovën në proceset integruese. Kjo është

---

<sup>1</sup> Flessenkemper, Tobias. European Western Balkans. ‘Berlin Plus’ will not change the game. 06.06.2017. <https://europeanwesternbalkans.com/2017/06/06/berlin-plus-will-not-change-the-game/>

<sup>2</sup> Bieber, Florian. European Western Balkans. “It is time to ditch the Berlin Process.” 10.07.2018. <https://europeanwesternbalkans.com/2018/07/10/time-ditch-berlin-process/>

treguar edhe në procesin e liberalizimit të vizave. Vazhdimi i Procesit të Berlinit është mundësi që Kosova të ec në hap me vendet e rajonit në procesin integruar dhe të vlerësohet në bazë të disa standardeve të përbashkëta për gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor.

Megjithatë, nëse Kosova nuk i përmbahet obligimeve që merr në këtë proces nuk tregon performancë të jashtëzakonshme, së paku me vendet e rajonit, atëherë ky proces vetëm mund të jetë një konfirmim tjetër që Kosova nuk ka vullnet për të punuar për procese integruar si prioritet shtetëror.

### Projektet infrastrukturore të konektivitetit

Një nga përfitimet më të prekshme të Procesit të Berlinit kanë qenë projektet infrastrukturore të konektivitetit përmes Kornizës Investuese për Ballkanin Perëndimor (WBIF). Edhe pse kjo kornizë ishte themeluar disa vite para Samitit të Berlinit, gjatë kohës sa ky instrument u integrua në Procesin e Berlinit është vërejtur një vëmendje më e madhe e këtij instrumenti dhe një momentum më i lartë i realizimit të projekteve. Ky instrument ka ndarë 1.3 miliardë euro për Ballkanin Perëndimor kryesisht në fushën e energjisë, transportit, ambientit dhe çështjeve sociale.

Janë mbi 17 projekte të cilat i ka përfituar Kosova në kuadër të këtij instrumenti siç janë:

1. Përmirësimi i ngrohjes qendrore në Prishtinë (Faza I dhe II);
2. Zbatimi i masave të efikasitetit të energjisë në ndërtesat publike në nivel komunal;
3. Studimi i Fizibilitetit dhe Zbatimi i masave të efikasitetit të energjisë në ndërtesat publike qendrore;
4. Studimi i Fizibilitetit - Ndërimi i karburantit dhe zgjerimi i sistemit për Ngrahjen Qendrore në Gjakovë;
5. Ujësullësi dhe kanalizimi komunal në Prishtinë (Faza II);
6. Studimet e fizibilitetit për impiantet për trajtim të ujërave të zeza në Kosovë;
7. Forcimi i menaxhimit të mbeturinave;
8. Studimi i fizibilitetit për mbrojtjen e Kanalit të Ibrit;
9. Studimi i fizibilitetit për Kanalin e Lepencit;
10. Ujësullësi dhe kanalizimi komunal në Prishtinë III;
11. Projekti për përmirësimin e arsimit në Kosovë;
12. Korridori Orient / Lindje-Med (R10) Rehabilitimi i Përgjithshëm Faza 1: Fushë Kosovë - kufiri me Maqedoninë;
13. Sektori E i autostradës Prishtinë - Merdare;
14. Sektori N9 i rrugës në Prishtinë Kijevë-Klinë deri në Zahaq;
15. Korridori Orient / Lindje-Med (R10) Rehabilitimi i Përgjithshëm Faza 2: Fushë Kosovë - Mitrovicë;
16. Korridori Orient / Lindje-Med (R10) Rehabilitimi i Përgjithshëm Faza 3: Mitrovicë - kufiri me Serbinë;

## 17. Linja hekurudhore Fushë Kosovë -Podujevë<sup>3</sup>.

Disa nga këto projekte ende nuk janë realizuar dhe kanë ngecur si rezultat i mosmarrëveshjeve në mes të Kosovës dhe Serbisë. Megjithatë, fondet janë zotuar dhe mund të shfrytëzohen në kohën kur arrihet një marrëveshje. Për më shumë, samitet e procesit të Berlinit ku janë të përfaqësuar udhëheqësit më të lartë të shteteve të Bashkimit Evropian gjithmonë i kanë kushtuar vëmendje projekteve të tilla dhe u kanë jap përkrahje politike. Kjo gjë luan rol të rëndësishëm në momentumin dhe efektivitetin e këtij instrumenti investues si dhe në seriozitetin e përgatitjes së projekteve të tilla nga vendet e Ballkanit Perëndimor.

### Iniciativa “Schengeni Ballkanik”

Në mungesë të një procesi të koordinuar për të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor të udhëhequr nga shtetet me ndikim në BE, ne ishim dëshmitar në muajt e fundit për iniciativa rajonale të cilat shkonin në kundërshtim me interesat e Kosovës. Iniciativa “Schengeni Ballkanik” edhe pse në sipërfaqe duket qëllim-mirë, tenton të krijoj një marrëveshje e cila do të ishte e dëmshme për Kosovën pa zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Kjo iniciativë e cila ishte më shumë ide e Kryeministrit të Shqipërisë, Edi Rama, dhe Kryeministrit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, nuk u pranua nga Kosova dhe Mali i Zi. Lëvizje të tilla do të mund të bëheshin vetëm me garanci të Bashkimit Evropian pas një konsultimi të të gjitha palëve. Pikërisht për këtë arsye, vazhdimi i Procesit të Berlinit bëhet edhe më i rëndësishëm.

Mirëpo kjo iniciativë duket se mund të vazhdojë edhe pse nuk përfshin shtetet të cilat do të ndikohen nga kjo si Kosova dhe Mali i Zi. Po ashtu, kjo iniciativë edhe mund të zgjerohet apo mund të ketë iniciativa tjera të ngjashme që në sipërfaqe duken qëllim-mirë por më shumë e ndajnë rajonin tonë sesa që e për afrojnë. Andaj, Kosova duhet të që bëjë thirrje që ‘Procesi i Berlinit’ të vazhdoj dhe ky proces të bëhet në koordinimin me Bashkimin Evropian. ‘Procesi i Berlinit’ ka qenë një nismë e duhur. Edhe pse progresi në disa fusha është treguar i ngadalshëm, është e evidente se nevojitet të ketë një ‘Berlin Plus’ dhe Kosova duhet të jetë nxitëse e zëshme e kësaj.

---

<sup>3</sup> Ministria e Integritimit Evropian. Qeveria e Republikës së Kosovës. *Korniza Investuese për Ballkanin Perëndimor*. <https://www.mei-ks.net/sq/wbif>

## TEMATIKAT NË PROCESIN E BERLINIT

	<b>BERLIN 2014</b>	<b>VIENNA 2015</b>	<b>PARIS 2016</b>	<b>TRIESTE 2017</b>	<b>LONDON 2018</b>	<b>POZNAN 2019</b>
<b>1</b>	Bashkëpunimi rajonal	Bashkëpunimi rajonal dhe zgjidhja e mosmarrëve shjeve bilaterale	Bashkëpunimi rajonal	Konektiviteti - Transporti dhe Energjia	Bashkëpunimi rajonal	Integrimi ekonomik rajonal
<b>2</b>	<b>Qeverisja së mirë</b>	<b>Sundimi i ligjit dhe qeverisja e mirë</b>	Konektiviteti dhe tregtia	Integrimi ekonomik rajonal	Siguria	Njohja e kualifikimeve të arsimit të lartë
<b>3</b>	Rritja e qëndrueshme ekonomike	Lufta kundër ekstremizmit radikalizmit	Prioriteti të rinia	Sektori privat dhe Zhvillimi i NVM-ve	Rinia dhe shoqëria civile	Ndërmarrësi a
<b>4</b>		Migrimi	Migrimi	Lidhshmëria e Rinisë	Rritja e mençur	Energjia e Pastër
<b>5</b>		Prosperiteti ekonomik	Lufta kundër terrorizmit radikalizmit	<b>Qeverisja, sundimi i ligjit</b>	Integrimi ekonomik rajonal	Integrimi i romëve
<b>6</b>		Konektiviteti i transportit		Shkenca	Mbështetja për sektorin privat	Transport
<b>7</b>		Konektiviteti i energjisë		Çështjet e pazgjidhura bilaterale	<b>Anti-korrupsioni</b>	Energjia
<b>8</b>		Integrimi i tregut		Shoqëria civile		Konektiviteti digjitale
<b>9</b>		Arsimi i Lartë, dhe Arsimi profesional		Lufta kundër terrorizmit radikalizmit		Personat e zhdukur krimet e luftës
<b>10</b>		Shoqëria civile		Migrimi		<b>Anti-korrupsioni dhe përcjellja e zotimeve</b>



## SUNDIMI I LIGJIT DHE MIRËQEVERISJA

### Berlin 2014

Samiti i Berlinit për Ballkanin Perëndimor në 2014 e përmbylli punën me tri përfundime që edhe u kthyen në shtylla të agjendës së procesit të Berlinit. Në mesin e përfundimeve për intensifikimi të bashkëpunimit rajonal në Ballkan Perëndimor dhe rritjes së prosperitetit përmes zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm, ishte edhe përfundimi për fuqizimin e qeverisjes së mirë. Në Deklaratën e Samitit të Berlinit, nën fushën “fuqizimi i qeverisjes së mirë” ishin dy pika si lloj zotimesh, e para që flitej për sundim të ligjit dhe e dyta për qeverisje të mirë. Pra qeverisja e mirë duke përfshirë këtu sundimin e ligjit u bë shtyllë e rëndësishme e procesit të Berlinit dhe rrjedhimisht u konfirmua si shtyllë kyçe e përafrimit të bashkimit evropian.

Në Deklaratën e Samitit thuhej se “Shtetet pjesëmarrëse pajtohen për ndërmarrjen e masave për të zhdukur korrupsionin dhe krimin e organizuar. Vendet e Ballkanit Perëndimor theksojnë vullnetin e tyre për të kryer reforma të mëtejshme me qëllim për të rritur besimin tek drejtësia në vendet e tyre për të mbështetur dhe forcuar pavarësinë e gjyqësorit të tyre dhe për të punuar së bashku më intensivisht përtej kufijve në struktura rajonale dhe dypalëshe<sup>4</sup>.”

Ky ishte zotimi i parë për përmirësim të sundimit të ligjit që gjashtë shtetet e Ballkanit Perëndimor, përfshirë këtu edhe Kosovën, morën në Procesin e Berlinit. Kjo ishte para pesë viteve dhe përpos disa arritjeve është e qartë që mbetet ende shumë për t’u bërë në këtë fushë nga gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor. Disa arritje, si vetingu në Shqipëri dhe besimi tek drejtësia në Maqedoninë e Veriut, apo edhe avancime ligjore në Kosovë, mund të përmenden këtu si arritje. Megjithatë, kjo mbetet nga pikat më të dobëta në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe një nga pengesat më të mëdha në rrugën drejt Bashkimit Evropian.

Ndërsa, në këtë Samit parimet e qeverisjes së mirë si kushtet për media pluraliste, sindikata të pavarura si dhe ekonomi të çliruar nga ndërhyrjet politike dolën si deklaratë zotuese të përbashkëta. Madje në deklaratë përfundimtare Gjermania, si nikoqire e këtij Samiti, u zotua se do të angazhohet për forcimin e lirisë së mediave në rajon.

### Vjena 2015

Samiti i Vjenës, një vit pas, ishte zgjeruar mjaft shumë në tema tjera për Ballkanin Perëndimor pasi u prezantua “Agjenda e Konektivitetit” kryesisht në transport dhe energji por kishte edhe tema tjera urgjente të atij viti si migrimi dhe ekstremizmi fetar. Megjithatë, sundimi i ligjit dhe qeverisja e mirë ishin prapë temat më prioritare në këtë Samit. Në Deklaratën Përfundimtare të këtij Samiti më shumë kishte një thirrje për vendet e Ballkanit Perëndimor sesa zotim shtesë nga këto vende. Tek sundimi i ligjit dhe qeverisja e mirë u deklarua se nevojiten më shumë përpjekje për të përshpejtuar proceset e brendshme të reformave, veçanërisht në fushat e sundimit të ligjit, qeverisjen ekonomike dhe reformën e administratës publike, si dhe në luftën kundër korrupsionit dhe kundër krimit të organizuar.

---

<sup>4</sup> The Berlin Process Info. *Final Declaration by the Chair of the Conference on the Western Balkans*. <https://berlinprocess.info/wp-content/uploads/2017/11/Final-Declaration-by-the-Chair-of-the-Conference-on-the-Western-Balkans.pdf>

Në këtë Samit, çështja e qeverisjes ekonomike dhe administratës publike ishin si shtesë e thirrjes së zakonshme të luftës kundër korrupsionit dhe kundër krimit të organizuar. Megjithatë, për shkak të vëmendjes që morri “Agjenda e Konektivitetit” me projektet infrastrukturore ku edhe vendet e rajonit tonë duket se marrin më shumë vëmendje, çështjet e qeverisjes së mirë dhe sundimit të ligjit disi u lënë anash.

### Paris 2016

Në Samitin e Parisit, çështjet e sundimit të ligjit pothuaj se u lënë anash plotësisht. Kishte një pikë më shumë formale në deklaratën përfundimtare ku u deklarua njëzëri se “sundimi i ligjit qëndron në zemër të procesit të zgjerimit, përfshirë përmes reformave gjyqësore, si dhe duke trajtuar krimin e organizuar dhe korrupsionin, dhe duke siguruar respektimin e plotë të të drejtave themelore.” Mirëpo, nuk kishte përcjellje të zotimeve të Samitit të Berlinit apo ndërtim mbi atë që u punua në Berlin dhe Vjenë.

Në këtë Samit u duk se ‘Procesi i Berlinit’ po kthehej në një proces vetëm për bashkëpunim rajonal përmes “Agjendës së Konektivitetit” dhe tema që më shumë preokuponin Bashkimin Evropian, si temat e migrimit dhe ekstremizmit fetar. Kjo në fakt është edhe çfarë vendet e Ballkanit Perëndimor do të donin ta shihni pasi çështjet e sundimit të ligjit dhe qeverisjes së mirë janë tema të ndjeshme për të cilat pak tregohet vullnet për të lëvizur në drejtim të duhur.

### Triestë 2017

Në Samitin e Triestes në 2017 u duk se vendet e Bashkimit Evropian pjesëmarrëse në Procesin e Berlinit e vërejtën që sundimi i ligjit dhe qeverisja e mirë ishte anashkaluar në Paris, andaj dhe kishte një vëmendje të shtuar. Në këtë Samit, vendet e Ballkanit Perëndimor dhe 10 vendet e BE-së pjesëmarrëse në këtë proces u deklaruan bashkërisht se përmirësimi i qeverisjes dhe sundimi i ligjit janë kërkesa thelbësore për anëtarësim në BE dhe për ndërtimin e një strukture të qëndrueshme ekonomike. Më tutje, në Triestë filluan edhe zotimet konkrete të vendeve të rajonit për sundimin e ligjit të cilat rezultuan me Deklaratën e Përbashkët Kundër Korrupsionit.

Kjo doli si rezultat i Autoritetit Kombëtar Italian Kundër Korrupsionit (ANAC) i cili kryesoi një punëtori me institucionet partnere nga Ballkani Perëndimor dhe Nismën Rajonale Kundër Korrupsionit (RAI), duke punuar në pesë çështje: parandalimi i korrupsionit; transparenca; prokurimi publik; sinjalizimi dhe konflikti i interesit. Aty u zotua se do të vijojnë seminare tematike, me bashkëpunimin e Komisionit Evropian, me qëllim që të thellohen njohuritë dhe të kontribuohet në përmirësimin e kapacitetit operacional. Kjo nismë tregoi interesim të partnerëve për të adresuar dhe bashkëpunuar në mënyrë efektive në çështje të integritetit. Pjesëmarrësit në punëtori ranë dakord të përcaktohen për një sërë zotimesh për të përmirësuar aftësinë për t’iu përgjigjur korrupsionit.

Në këtë Samit, vendet e Ballkanit Perëndimor në Deklaratën e Përbashkët Kundër Korrupsionit në Triestë u deklaruan se ‘shprehin vullnet të fortë politik’ për të:

- forcuar sistemet tona të parandalimit të korrupsionit, duke kombinuar qasjen represive ndaj luftës kundër korrupsionit me qasjen parandaluese dhe respektimin e autonomisë së plotë të organeve përgjegjëse;
- thelluar dhe zgjeruar gjithnjë e më shumë transparençën, duke marrë parasysh që transparenca e shtuar rrit kontrollin qytetar mbi sjelljen e zyrtarëve publikë, veçanërisht te qeveritë lokale;

- forcuar profesionalizimin e stafit të prokurimit publik për të përmirësuar performancën e sistemeve të prokurimit publik, të cilat janë pjesë e rëndësishme e ekonomive kombëtare, por gjithashtu shumë të cënueshme nga korrupsioni dhe infiltrimi i krimit të organizuar;
- për të nxitur aplikimin e sistemeve të prokurimit elektronik;
- përmirësuar sistemet tona legjislative të sinjalizimit dhe konfliktit të interesit, për të zbardhur fenomenin e keqadministrimit në vend të punës dhe sjelljen e zyrtarëve publik;

Më tutje, qeveritë e Ballkanit Perëndimor u inkurajuan të miratojnë dhe aplikojnë Traktatin Ndërkombëtar të Nismës Rajonale Kundër Korrupsionit për Shkëmbimin e të Dhënave për Deklarimin e Pasurisë dhe Konfliktin e Interesit. Krijimi i mekanizmit për shkëmbimin e të dhënave midis organeve kombëtare të mbikëqyrjes në Ballkanin Perëndimor u tha se do të forcojë edhe më tej përgjegjësinë e zyrtarëve publikë dhe do ta avancojë frenimin e korrupsionit në nivel rajonal.

Për t'i arritur këto objektiva, këto vende shprehën vullnetin e tyre të përdorin një gamë të gjerë të mjeteve dhe metodologjive ekzistuese për të parandaluar korrupsionin bazuar në praktikatat më të mira ndërkombëtare, duke ofruar edukim dhe trajnim, duke inkurajuar përfshirje qytetare dhe vetëdijësim në praktikatat antikorrupsion, organizuar bashkëpunim më të ngushtë dhe vizita studimore, hartuar rekomandime konkrete dhe ofruar udhëzime për të përmirësuar krijimin dhe zbatimin e masave legjislative dhe administrative për korrupsionin dhe zbatimin më të mirë të politikave antikorrupsion.

### Londër 2018

Samiti i Londrës në 2018, që parashihej të ishte edhe samiti i fundit i Procesit të Berlinit, e vazhdoi momentumin e Samitit të Triestes për sundimin e ligjit dhe mirëqeverisjes duke u kthyer në hapësirë për të matur progresin e vendeve të Ballkanit Perëndimor në luftën kundër korrupsionit. Në këtë Samit, i ndarë në grupe tematike, ishte shtyrë që vendet e këtij rajoni veçanërisht të zotohen për çështje që do të jenë parandaluese të korrupsionit. Andaj dhe në këtë Samit, Shqipëria, Kosova, Bosnja e Hercegovina dhe Maqedonia japën zotime të veçanta dhe konkrete kundër korrupsionit për vendet e tyre përmes deklaratave të veçanta.

Deklarata Përfundimtare e Udhëheqësit të Samitit tha se u mirëpretën zotimet e gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor për të luftuar korrupsionin dhe adresuar krimin e organizuar. Ndërsa, Deklarata e Zotimeve të Qeverisë së Kosovës për Fushën Anti-Korrupsion, e bërë publike në këtë Samit, u përqendrua në ekspozimin e korrupsionit, ndëshkimin e të korruptuarve dhe dëbimin e kulturës së korrupsionit. Në kuadër të kësaj u dhanë zotime konkrete për të arritur këto tri qëllime.

Në këtë Samit, vendet e Ballkanit Perëndimor gjithashtu ranë dakord të mbesim të përkushtuar për të përvetësuar demokracinë, respektimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, dhe sundim të ligjit, dhe se shoqëria civile dhe mediat e pavarura luajtën rol vendimtar.

### Poznan 2019

Në Samitin pasues në Poznan të Polonisë, gjatë Presidencës së Këshillit të Bashkimit Evropian nga ky shtet, liderët e Ballkanit Perëndimor rikonfirmuan zotimin e tyre për forcimin e sundimit të ligjit, të drejtat themelore dhe qeverisjen e mirë në rajon. Vendet pjesëmarrëse

ranë dakord që të përqendrohen në ndarjen e praktikave të mira për luftimin e korrupsionit dhe për të siguruar zbatim praktik të strategjive dhe planeve të veprimit kundër korrupsionit. Në kuadrin ekzistues ndërkombëtar kundër korrupsionit, duke përfshirë Konventën e OKB-së Kundër Korrupsionit, në të cilën janë palë nënshkruese partnerët e rajonit, liderët u deklaruan të vendosur që ta vazhdojnë luftën kundër korrupsionit si prioritet kryesor në agjendën e Procesit të Berlinit. Më tutje, udhëheqësit e vendeve të Ballkanit Perëndimor i bënë thirrje BE-së që ta vazhdojë mbështetjen e saj për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit në rajon.

Megjithatë, Samiti i Poznanit u kthye në zgjerimin e temave në Samit dhe hodhi hije në specifikat e progresit për sundim të ligjit në gjashtë vendet e rajonit. Pasi ky Samit kishte një përbërje më të gjerë të pjesëmarrësve, edhe temat pritej që të zgjerohen. Samitet e ardhshme të agjendës “Berlin Plus” do të vazhdojnë me këtë pjesëmarrje më të zgjeruar ku rol në këtë proces do të kenë edhe vendet tjera të Bashkimit Evropian përpos 10 vendeve të BE-së që nga fillimi i Procesit të Berlinit<sup>5</sup>.

### Roli i forumit të shoqërisë civile

Një prej shtyllave më të rëndësishme për demokratizimin e një shteti është krijimi i një sektori të fortë në shoqëri civile. Zëri i shoqërisë civile është vlerë e shtuar edhe e Procesit të Berlinit, madje është e kyçur drejtpërdrejtë në të gjitha zhvillimet rreth përgatitjes së Ballkanit Perëndimor për t’u integruar në BE.

Samiti i Vjenës konsiderohet si një prej takimeve më të rëndësishme edhe për shkak të vendimit për angazhimin e shoqërisë civile në të tilla samite përmes Forumit të Shoqërisë Civile dhe Forumit për Biznese. Në deklaratën e samitit thuhet se, zëri i shoqërisë civile duhet të jetë pjesë e procesit të integritimit në BE të shteteve të Ballkanit Perëndimor.

Përgjatë forumeve të shoqërisë civile të Ballkani Perëndimor që i kanë përcjell Samitet e procesit të Berlinit janë diskutuar fusha të ndryshme të shoqërisë në të cilat është e nevojshme të rritet ndikimi i shoqërisë civile. Një prej sfidave më të reja me të cilat është ballafaquar Ballkani Perëndimor viteve të fundit ka qenë rritja e skepticizmit ndaj Bashkimit Evropian dhe demokracisë si tërësi në këtë rajon. Për këtë, organizatat e shoqërisë civile janë mobilizuar që të kanë shprehin kërkesat e tyre karshi Bashkimit Evropian, pas vlerësimit të rrezikut që mund të shfaqet nëse kjo çështje mbetet e pa-adresuar.

Në samitin e Vjenës të mbajtur me 2015, organizatat e shoqërisë civile kanë kërkuar që të sigurohet liria e shprehjes dhe mediave të lira, duke ofruar mbrojtje ligjore dhe kushte të punës gazetarëve, pavarësi transmetuesit publik duke siguruar financim afatgjatë të mediave publike nga shteti mirëpo duke parandaluar monopolizimin e mediave. Përveç në Samitin e Vjenës, rëndësia e qeverisjes demokratike dhe ruajtjes së vlerave demokratike u diskutua edhe në samitin e mbajtur në Paris në 2016-tën, në të cilën u shpалosen kërkesa konkrete ndaj Bashkimit Evropian për ruajtjen e demokracisë në Ballkanin Perëndimor. Nga BE u kërkuar që të mbështesin drejtpërdrejtë organizimet dhe protestat që janë pro mbrojtjes të demokracisë. Ndërsa arritjen e këtyre objektivave ky samit ka paraparë t’a bëjë duke u fokusuar në zhvillimin e programeve për të rinjtë dhe grupeve të marginalizuara. Gjithashtu,

---

<sup>5</sup> Nga vendet e Bashkimit Evropian në fillim të Procesit të Berlinit ishin: Gjermani, Franca, Mbretëria e Bashkuar, Italia, Austria, Polonia si dhe Greqia, Bullgaria, Sllovenia dhe Kroacia pasi kishin përaftrim edhe territorial me gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor.

shkëmbimi i përvojave dhe rritja e bashkëpunimit rajonal mes të rinjve është një ndër shtyllat kryesore e ruajtjes së demokracisë dhe vazhdimit të frymës demokratike, pro-evropiane në Ballkanin Perëndimor.

Në samitin e mbajtur në Prishtinë në 2017-tën u diskutua rreth përmirësimit të punës së OSHC-ve në rajon, ashtu që ato të kenë më shumë ndikim në arritjen e objektivave të cila ti kanë caktuar vetes. Ndër të tjera, organizatat pjesëmarrëse u pajtuan se Forumi i Shoqërisë Civile duhet të jetë më i hapur, gjithëpërfshirës dhe llogaridhënës. Ndërsa në anën tjetër, duhet të përmirësohet komunikimi i punës së samiteve tek grupet e targetuara, me theks tek komunitetet dhe të rinjtë.

Temë e cila u diskutua në samitin e Triestes në po të njëjtin vit është ajo e sundimit të ligjit, dhe implikimet që sundimi i ligjit i ka në luftën kundër korrupsionit. Roli i BE-së vazhdon të jetë kyç në luftën kundër korrupsionit, porse ajo duhet të intensifikojë bashkëpunimin me OSHC-të e rajonit. Ndikimi i OSHC-ve duhet të rritet edhe në përmbajtjen e raportit të progresit, para përpilimit të tij, ashtu që të dhënat që mblidhen të dërgohen nga OSHC-të vendore. Kjo kushtëzon institucionet vendore të jenë më të hapura në ofrimin e të dhënave, si dhe të japin të dhëna më kredibile. Organizatat e shoqërisë civile u tha se duhet gjithashtu të ndihmojnë në krijimin e një sistemi të krahasimit alternativ për rajonin për raste të veçanta përfshirë ato të korrupsionit. Diskutimi rreth sundimit të ligjit dhe luftës kundër korrupsion vazhdoi edhe në samitin e mbajtur në Tiranë në 2017, ku u diskutuan fushat në të cilat BE duhet të bashkëpunojë me qeveritë e rajonit, si dhe mënyrat që BE duhet të ushtrojë presion tek këto. Ndër të tjera, u përmend rëndësia e përmirësimit të monitorimit nga ana e BE-së, rritja e transparencës së procesit të integritetit evropian, si dhe marrja parasysh e rekomandimeve nga OSHC-të e rajonit.

## ZOTIMET E QEVERISË SË KOSOVËS ANTI-KORRUPSION

Qeveria e Kosovës në Samitin e Londrës u zotua se luftën kundër korrupsionit do ta vazhdojë duke u fokusuar në tre fusha – ekspozimin e korrupsionit, ndëshkimin e të korruptuarve dhe dëbimin e kulturës së korrupsionit. Masat që do të merren për të luftuar korrupsionin janë në të njëjtën vijë me Deklaratën e Përbashkët Kundër Korrupsionit në Triestë përmes të cilës shtetet u zotuan se përveç se do të përmirësojnë sistemin parandalues të korrupsionit, do të luftojnë që korrupsioni të mos vazhdojë të mbetet e vërteta për Ballkanin Perëndimor. Shtetet u pajtuan për nevojë të bashkëpunimit rajonal për të eliminuar sfidat si parandalimi i korrupsionit, profesionalizimi i prokurimit publik, rritja e llogaridhënies nga zyrtarët publik, përmirësimi i kornizës ligjore për sinjalizuesit e korrupsionit dhe konfliktit të interesit, si dhe arritja e Traktit për Shkëmbimin e të Dhënave për Deklarim të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit, për të cilën u zotua edhe Qeveria e Kosovës që do ta miratojë në përputhje me procedurat kombëtare dhe kushtetuese për miratimin e traktateve.

Qeveria e Kosovës është zotuar se do të sigurohet për zbatim të rreptë të ligjit në prokurim publik, për mbrojtjen e sinjalizueseve si dhe në administratën publike me qëllim të përmirësimit të transparencës dhe llogaridhënies nga autoritetet publike. Transparenca financiare u tha se duhet të përmirësohet edhe nga partitë politike, për këtë nevojitet që të rritet

integriteti institucional duke u siguruar që organet anti-korrupsion të jenë plotësisht të pavarura, të afta dhe të kenë burime të mjaftueshme për të cilat do të sigurohet Qeveria e Kosovës. Përveç këtyre, me qëllim të ndërrimit të luftës kundër-korrupsion, duke u zhvendosur më shumë në parandalimin e tij, do të implementohen programe të edukimit kundër korrupsionit, do të sigurohet që të ketë emëtime meritokratike në shërbimin civil, do të bëhet rivlerësimi i gjyqtarëve, prokurorëve, këshilltarëve juridikë dhe zyrtarëve të zbatimit të ligjit.

Më poshtë gjinden Zotimet e Qeverisë së Kosovës në fushën e Anti-Korrupsionit të bëra në Konferencën e Londrës me 2018. Pritet që këto zotime do të përcillen nga Komisioni Evropian edhe në Samitet e ardhshme. Madje kjo ishte temë në samitin pasues në Poznan në vitin 2019. Tek prokurimi publik dhe sinjalizuesit ka një përparim nga Samiti i Londrës në 2018. Mirëpo në zotimet tjera nuk ka arritje të dukshme ende dhe këto zotime mbetën detyrë për Qeverinë e re të Kosovës.

### Ekspozimin e korrupsionit

#### Partneritetet Publike Private

- Përmirësimi i rrjedhës së informacionit ndërmjet sektorit financiar dhe NjIF për të siguruar zbatimin e ligjit me inteligjencë të nevojshme për të zbuluar dhe penguar pastrimin e parave që kanë lidhje me korrupsionin;
- Sigurimi i partneriteteve të vazhdueshme për ndarjen e informacionit publik privat për të bashkuar qeveritë, zbatimin e ligjit, rregullatorët dhe sektorin financiar për të parandaluar dhe luftuar pastrimin e parave të lidhura me korrupsionin;
- Angazhimi për të punuar së bashku me vendet rajonale dhe vendet e tjera për të shkëmbyer informacione për të siguruar përgjigjen më efektive ndaj pastrimit të parave ndërkombëtare;
- Bashkëpunimi në mënyrë aktive me të dhe të marrë pjesë në nismat e udhëhequra nga rrjeti 'Egmont' i Njësive të Inteligjencës Financiare.

#### Prokurimi publik dhe kontraktimi i hapur

- Implementimi i rreptë i dispozitave ligjore të Ligjit të Prokurimit Publik dhe akteve nënligjore të tij;
- Përmirësimi i zbatimit të rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm;
- Implementimi i sistemit elektronik të prokurimit publik në të gjitha aktivitetet e prokurimit publik dhe përdorimi i sistemit elektronik të prokurimit për publikimin e informacionit të standardizuar të prokurimit publik, në mënyrë që të jetë i arritshëm për të palët e interesuara siç përcaktohen në dispozitat ligjore të ligjit të prokurimit publik;

#### Taksat

- Forcimi i standardeve profesionale dhe aftësive të hetimit të Administratës Tatimore të Kosovës.

#### Sinjalizuesit

- Zbatimi i legjisllacionit për mbrojtjen e sinjalizuesve, për mbrojtjen e informacionit të marrë nga sektori publik dhe privat dhe inkurajimi i qytetarëve dhe punonjësve të raportojnë rastet e korrupsionit.

## Pronësia përfituese

- Sigurimi i autoriteteve kompetente që kryejnë hetime për të pasur qasje të plotë dhe efektiv në informacione mbi pronësinë përfituese duke siguruar informacion të plotë, të saktë dhe me kohë në lidhje me pronësinë përfituese.

## Ndëshkimin e të korruptuarve

### Aftësitë e zbatimit

- Sigurimi që të gjithë organet antikorrupsion të jenë plotësisht të pavaruar, të afta, me resurse të nevojshme dhe të marrin mbështetjen dhe bashkëpunimin e plotë nga të gjitha degët e qeverisë ;

## Riparimi i Pasurisë dhe Kthimi i Pasurive

- Përmirësimi dhe forcimi i legjislacionit të aktiveve dhe rikuperimit të pasurive.

## Dëbimin e kulturës së korrupsionit

### Integriteti institucional

- Zbatimi i legjislacionit në lidhje me integritetin e personave që ushtrojnë funksione publike.
- Përmirësimi i transparencës së financimit të partive politike me mekanizmat funksionues të sistemeve të kontrollit dhe auditimit.
- Përmirësimi i kornizës ligjore dhe mekanizmave organizative të zbulimit dhe parandalimit të konfliktit të interesit në lidhje me zyrtarët publik.
- Mbështetja e iniciativës për nënshkrimin e Traktatit Ndërkombëtar për Shkëmbimin e të Dhënave për Deklarimin e pasurive të Zyrtarëve të Lartë Publikë dhe Konfliktin e Interesit dhe do ta miratojë atë në përputhje me procedurat kombëtare dhe kushtetuese për miratimin e traktateve dhe konventave ndërkombëtare dhe rajonale;
- Emërimet e stafit të shërbimit civil të bëhen me meritë dhe në mënyrë të pavarura dhe transparente;
- Krijimi dhe zbatimi i legjislacionit që lejon rivlerësimin e gjyqtarëve, prokurorëve, këshilltarëve juridikë dhe zyrtarëve të zbatimit të ligjit;
- Rritet dinamika e zbatimit të Strategjisë Kombëtare Kundër Korrupsionit dhe Planit të Veprimit;
- Forcimi i rolit të Agjencisë Kundër Korrupsionit përmes miratimit të ndryshimit të kornizës ligjore, rritjes së aftësive administrative, rritjes së buxhetit, me qëllim parandalimin dhe luftimin e korrupsionit në mënyrë efektive;
- Promovimi i aftësive më të forta në sektorët e mbrojtjes dhe të sigurisë që janë të prekshëm nga kërcënimi i korrupsionit, përmes pjesëmarrjes në Qendrën e Integritetit të Ndërtimit të mbështetur nga Mbretëria e Bashkuar.

## Edukimi kundër korrupsionit

- Zbatimi i programeve të edukimit kundër korrupsionit duke angazhuar organizata në sektorin publik dhe privat në bisedime dhe dialog mbi masat parandaluese.

## Sistemi Ndërkombëtar

- Angazhimi, me ndihmën dhe mbështetjen e Bashkimit Evropian, në mënyrë që Kosova të bëhet anëtare e organizatave ndërkombëtare dhe rajonale të misionit për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit.

## OBLIGIMET TJERA TË KOSOVËS NË PROCES

### Bashkëpunimi rajonal dhe pajtimi

Edhe pse pajtimi dhe bashkëpunimi rajonal janë dy koncepte dhe procese të ndryshme, ato më së miri mund të ndodhin vetëm kur janë së bashku. Prandaj, ‘Procesi i Berlinit’ konsiderohet si lokomotivë e nxitjes së bashkëpunimit mes këtyre vendeve, me këtë rast edhe të pajtimit të tyre dhe zgjidhjes së kontesteve nga e kaluara. Projektet dhe investimet e përbashkëta mund t’i ndihmojë vendet e Ballkanit Perëndimor në krijimin e marrëdhënieve të mira ndërfaqjësore dhe integrimin e tyre në BE.

Realisht tema e pajtimit ka qenë temë që nga samiti i parë, i mbajtur në Berlin në vitin 2014. Pavarësisht tentativave të shteteve perëndimore, në këtë pikë timonin mund ta kenë vetëm liderët e shteteve që kanë ende konflikte të tilla.

Për shkak të rëndësisë, tema për pajtim ka vazhduar edhe në samitet tjera. Në Samitin e Vjenës<sup>6</sup> është përshëndetur përfundimi i katër marrëveshjeve ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës, në kontekst të normalizimit të marrëdhënieve mes këtyre dy vendeve, duke nënvizuar rëndësinë e mbështetjes së mëtutjeshme. Në këtë drejtim, hap të rëndësishëm kanë bërë Mali i Zi me Bosnjën e Hercegovinën, të cilat e kanë nënshkruar marrëveshjen për vendosjen e kufijve.

Në samitin e tretë<sup>7</sup>, i mbajtur në kryeqytetin francez në korrik të vitit 2016, çështja e pajtimit dhe bashkëpunimit rajonal ka qenë vazhdimësi nga samitet e kaluara, duke bërë thirrje për zgjidhjen e konflikteve dhe kontesteve mes këtyre shteteve. Në Paris, të gjashtë shtetet e rajonit kanë riafirmuar zotimet që kishin dhënë në Deklaratën Përfundimtare të samitit të vitit 2015 lidhur me zgjidhjen e këtyre konflikteve.

Përveç këtyre zotimeve, në këtë samit është lidhur një prej marrëveshjeve më të rëndësishme përmes së cilës është themeluar Zyra Regjionale për Bashkëpunimin Rinor (RYCO). Kjo zyrë sipas kësaj marrëveshjeje, do ta ketë rolin e mbështetjes së aktiviteteve që promovojnë pajtim të popujve, programe të rikujtueses, diversitetit, shkëmbimit të kulturave, lëvizjen e të rinjve, pjesëmarrjen qytetare dhe promovimin e vlerave demokratike.

Edhe samiti i mbajtur në Trieste të Italisë<sup>8</sup> i ka lënë hapësirë të veçantë çështjes së pajtimit dhe bashkëpunimit rajonal. BE-ja edhe në këtë samit ju ka bërë thirrje gjashtë shteteve të rajonit duke theksuar gatishmërinë për t’i ndihmuar në përmirësimin e raporteve të lëna pezull, me ç’ rast këto të fundit kishin ritheksuar se do të bëjnë përpjeke për të bërë progres në këtë drejtim.

---

<sup>6</sup> The Berlin Process Info. *Final Declaration by the Chair of the Vienna Western Balkans Summit 27 August 2015.* <https://berlinprocess.info/wp-content/uploads/2017/11/Final-Declaration-by-the-Chair-of-the-Vienna-Western-Balkans-Summit.pdf>

<sup>7</sup> The Berlin Process Info. *Final Declaration by the Chair of the Paris Western Balkans Summit 4 July 2016.* <https://berlinprocess.info/wp-content/uploads/2017/11/Final-Declaration-by-the-Chair-of-the-Paris-Western-Balkans-Summit.pdf>

<sup>8</sup> The Berlin Process Info. *Declaration by the Italian Chair.* <https://berlinprocess.info/wp-content/uploads/2017/11/Declaration-by-the-Italian-Chair.pdf>



Progres në këtë drejtim, shtetet e Ballkanit Perëndimor kanë bërë në Samitin e Londrës, samit i cili ka treguar edhe njëherë që Britania e Madhe nuk heq dorë nga Ballkani Perëndimor, duke dhënë edhe mbështetje financiare për fusha të ndryshme, e atë në vlerë prej 80 milion sterlina deri në vitin 2020.

Në këtë drejtim, gjatë këtyre ditëve të samitit, janë nënshkruar dy deklarata të përbashkëta, njëra për krimet e luftës dhe fatin e personave të zhdukur dhe tjetra për bashkëpunim rajonal dhe fqinjësi të mirë<sup>9</sup>.

Samiti i fundit i mbajtur në Poznan të Polonisë<sup>10</sup>, kishin theksuar nevojën për t'u marrë seriozisht me implementimin e zotimeve që kanë të bëjnë veçanërisht me pajtimin dhe zgjidhjen e konflikteve, të cilat ndikojnë në zhvillimin e proceseve në të gjitha fushat e bashkëpunimit.

Në këtë samit, shtetet pjesëmarrëse sërish ishin thirrur në zotimet e Samitit të Vjenës dhe në Deklaratën e Bashkëpunimit Rajonal dhe Fqinjësisë së Mirë. Palët po ashtu kishin theksuan rëndësinë e Traktatit mbi Miqësinë, Bashkëpunimin dhe Fqinjësinë e Mirë mes Bullgarisë dhe Maqedonisë së Veriut dhe Marrëveshjes së Prespës ndërmjet Republikës Helenike dhe Maqedonisë së Veriut.

#### Agjenda e konektivitetit (transporti dhe energjia)

'Procesi i Berlinit' i'a ka vendosur vetit për qëllim vënie të themeleve të një ekonomie të përbashkët dhe të qëndrueshme dhe një ekonomi që e ka rolin e saj në shoqëri pa ndërhyrje të politikës. Një prej çështjeve tjera që përmendet që në samitin e parë është edhe rritja e konkurrencës. Në këtë kontekst rreth një muaj pas samitit të parë, është mbajtur një konferencë rajonale në Mal të Zi.

Nga ana tjetër, Gjermania në Samitin e Berlinit është treguar e gatshme të marrë masa të mëtejshme në kuadrin e programeve ekzistuese për bashkëpunimin ekonomik dhe zhvillimin me qëllim mbështetjen e vendeve të rajonit në përdorimin sa më efektiv të masave evropiane për afrimin e atyre me BE-në nëpërmjet instrumentit të asistencës së paraaderimit – IPA.

Në tetor të vitit 2014, në një konferencë të mbajtur në Beograd për çështje ekonomike dhe për konektivitet, liderët kanë ra dakord që çdo vit të përgatisin Programet Kombëtare të Reformave Ekonomike (NERP), ku përfshihet programi i makroekonomisë, fiskal, i reformave strukturore dhe i konkurrencës. Këto programe kanë mbështetje teknike nga Komisioni Evropian dhe te i njëjti dorëzohen nga qeveritë e rajonit tonë<sup>11</sup>.

Samiti i Vjenës bëri akoma më shumë në këtë fushë, duke u miratuar kështu gjashtë projekte për infrastrukturën rrugore. Këtu përfshihen një terminal intermodal, dy ura dhe tri projekte hekurudhore. Po ashtu, këto shtete kanë pranuar të implementohen dhe 4 projekte për energji, ku të gjitha së bashku arrijnë shifra rreth 200 milion euro.<sup>12</sup> Për këtë, shtetet e rajonit kishin

---

<sup>9</sup> The Berlin Process Info. *Chair's Conclusion*. London. <https://berlinprocess.info/wp-content/uploads/2018/07/Chair's-Conclusions-of-the-Heads'-meeting-of-the-London-Western-Balkans-Summit-10-July-2018.pdf>

<sup>10</sup> The Berlin Process Info. *Western Balkans Summit Poznań- Chair's Conclusion*. [https://berlinprocess.info/wp-content/uploads/2019/07/chairs\\_conclusions.pdf](https://berlinprocess.info/wp-content/uploads/2019/07/chairs_conclusions.pdf)

vendosur që të krijojnë një treg rajonal të energjisë, ku duhet të priorizohen “masat e buta” të energjisë, implementimin e të cilave do ta drejtojë Sekretariati i Komunitetit të Energjisë.

Samiti i vitit 2017, ai i Triestes ishte fokusuar në vazhdimin e agjendës për reformimin e transportit dhe energjisë, përmirësimin e rritjes për rritjen ekonomike, rritja e mundësive për biznese dhe tërheqja e investimeve. Pjesëmarrësit u pajtuan për shtatë projekte tjera të ndërlikshme që kapin vlerë mbi 500 milion euro.

Samiti i Triestes ka rëndësi edhe për shkak të nënshkrimit të Traktatit të Komunitetit të Transportit, ku konsiderohet edhe traktati i parë me BE-në dhe Komisionin Evropian<sup>13</sup>. Ky samit vlerësohet edhe për shkak të krijimit të Zonës Ekonomike Rajonale (ZER), e cila bazohet në marrëveshjen e CEFTA-së, rregullave të BE-së dhe parimet që i proklamoi Marrëveshja për Stabilizim Asociim. Sipas Deklaratës së Triestes, thuhet se kjo iniciativë do të mundësonte lëvizjen e lirë të mallrave, shërbimeve, investimeve në këto gjashtë shtete. Hapat që duhet të ndërmarrin këto shtete për rritjen ekonomike dhe lehtësimin e procedurave për lehtësimin e mallrave janë disa nga kriteret për t’u anëtarësuar në BE. Lidhur me këtë, Komisioni Evropian e ka ndihmuar këtë iniciativë me 7 milion euro, veçmas në përmirësimin e ambientit për biznese. Mirëpo, kjo iniciativë kërkohej të nënshkruhej nga çdo shtet veç e veç, me ç’ rast Kosova dhe Mali i Zi<sup>14</sup> e kishin kundërshtuar fillimisht për shkak të përvojës me CEFTA-në, e cila sipas tyre nuk ka funksionuar siç ishte planifikuar. Pavarësisht këtyre pengesave, ZER në fund ishte përkrahur nga gjashtë shtetet e rajonit, plan i cili do të mbikëqyret nga Këshilli për Bashkëpunim Rajonal<sup>15</sup>.

Një prej samiteve më të suksesshme në sferën ekonomike është edhe Samiti i Poznanit. Liderët e shteteve të Ballkanit Perëndimor në këtë samit kanë riafirmuar zotimet e tyre për ZER-në, të cilët edhe kanë mirëpritur planin e veprimit të saj dhe të arriturat e deritanishme.

Në këtë samit është nënshkruar marrëveshja për përgatitjen e Strategjisë për Menaxhimin e Riskut. Po ashtu, pjesëmarrësit kanë përshëndetur fillimin e implementimit të protokollit të pestë që ka të bëjë me marrëveshjen për lehtësimin e tregut. Përveç kësaj, të njëjtit kanë pranuar edhe një protokoll shtesë të marrëveshjes së CEFTA-së. Pjesë e rëndësishme e këtij samiti ishte edhe vendimi për krijimin e pikave të vetme të kontaktit për shërbimet. Në samit është përmendur edhe rëndësia e një protokollit të tetë të CEFTA-së që do ta rregullonte pjesën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve tregtare.

Për ta përforcuar sektorin e bizneseve private, Komisioni Evropian kishte ofruar garanci financiare në vlerë prej 150 milionë eurosh, të cilat do të alokohen përmes projekteve që do të hapen gjatë këtij vitit (2019). Kjo shumë do të ndahet sidomos për bizneset që merren me bujqësi, tregti dhe digjitalizim ose për investimet e gjelbra qoftë si biznese familjare apo iniciativa të komunave. Gjithashtu, është mirëpritur edhe krijimi i platformës online, e cila do të kontribuojë në përmirësimin e konkurrencës në ekonominë e shteteve të Ballkanit Perëndimor.

## **Agjenda e konektivitetit - transporti**

Agjenda e Konektivitetit si një prej komponentëve kyçe të samitit të parë ka ruajtur rol jashtëzakonisht të madh në ndërlidhjen e gjashtë shteteve mes vete dhe këtyre të fundit me shtetet e BE-së. Kjo agjendë ka të bëjë me ndërtimin e një infrastrukture të mirë dhe për ta lehtësuar lëvizjen e mallrave dhe shërbimeve, me ç'rast rritet edhe potenciali për vende të reja pune. Kjo sigurisht pastaj e nxitë rritjen e konkurrencës dhe zbehjen e monopolit të bizneseve të caktuara.

Kancelarja Merkel në një konferencë për media pas përfundimit të Samitit të Berlinit, kishte thënë se Gjermania do të angazhohet që Ballkani Perëndimor të integrohet në BE, me këtë rast edhe projektet për infrastrukturën do t'i përmirësojnë kontaktet ndërmjet shteteve<sup>16</sup>. Në këtë drejtim, shtetet e Ballkanit Perëndimor kanë rastin të përfitojnë nga kjo agjendë në infrastrukturë rrugore dhe atë të energjisë, si dhe në sistemin digjital. Ndarja dhe përzgjedhja e projekteve kryesore ka filluar të bëhet në një takim të liderëve të vendeve në prill të vitit 2015 në Bruksel, në të cilën e kanë dizajnuar Rrjetin Kryesor të Transportit.

Për Kosovë, ishin përzgjedhur projektet Hekurudha Krushevac (Serbi) – Kralevo (Serbi) - Prishtinë (Kosovë) – Shkup (Maqedoni e Veriut); dhe Ndërtimi i autostradës Prishtinë (Kosovë) – Shkup (Maqedoni i Veriut) dhe Lezhë – Prishtinë (Kosovë) – Nolevac (Serbi)<sup>17</sup>. Në Samitin e Vjenës janë miratuar gjithsej 10 projekte, gjashtë në infrastrukturë dhe katër për energji. Një çështje e rëndësishme është edhe definimi i masave të forta dhe masave të buta në investimet e infrastrukturës, të cilat shtetet e WB6 janë zotuar që do t'i aplikojnë. “Masat e forta” përfshijnë zbatimin e projekteve infrastrukturore brenda këtyre vendeve dhe në gjithë rajonin. Ndërkaq, “masat e buta” kanë të bëjnë me procedurat e kalimit të kufijve, sistemin e informimit, reformimin e hekurudhave, sigurinë në rrugë, pengimin e qasjes për palët e treta dhe masa të tjera<sup>19</sup>. Këto masa zakonisht ndihmojnë zbatimin e projekteve që kanë të bëjnë si me infrastrukturën e transportit ashtu edhe atë të energjisë.

Një prej samiteve që e ka fuqizuar edhe më shumë komponentin e konektivitetit është ai i Poznanit, ku liderët kanë përsëritur zotimet për ta përmirësuar rrjetin e transportit, energjisë dhe sistemin digjital, përmes së cilave krijohet stabilitet politik dhe ndikon në zhvillimin e fushës socio-ekonomike. Me këtë rast, shtetet kanë përfituar fillimin e tetë projekteve ndërlidhëse me investim total rreth 700 milionë euro. Nga kjo shumë, BE-ja ka financuar në vlerë prej 180 milionë euro. Nga këtë rast, Kosova ka përfituar një projekt me vlerë prej 56.1 milionë euro, nga të cilat mjete shuma prej 27.4 milionë ishte investim i BE-së.

## **Agjenda e Konektivitetit - Energjia**

Komponenta e dytë e konektivitetit ka të bëjë me energjinë, e cila konsiderohet si një prej nismave kyçe për reformimin e tregut energjetik. Në Samitin e Vjenës, gjashtë shtetet e Ballkanit Perëndimor kanë pranuar që të implementohen katër projekte për energjinë, për të cilat ishte paraparë shuma prej 200 milionë eurosh. Për këtë arsye, shtetet e rajonit kishin vendosur që të krijojnë një treg rajonal të energjisë, ku duhet të priorizoheshin “masat e buta” të energjisë, implementimin e të cilave do ta drejtonte Sekretariati i Komunitetit të Energjisë.

Pas një viti, në Samitin e Parisit ishte mirëpritur rritja e mbështetjes financiare nga BE, në vlerë prej 50 milionë për fushën e energjisë. Përveç kësaj, BE kishte përgatitur edhe një plan për Ballkanin Perëndimor për zhvillimin e hidrocentralit në mënyrë që të balancohet gjenerimi i energjisë me problemet mjedisore.

Gjithashtu është ripërmendur aplikimi i “masave të buta” që ndërlidhen me rrjetin e integruar të energjisë dhe transportit. Për këtë, në këtë samit janë kërkuar përpjekje nga shtetet e Ballkanit Perëndimor për t’i vazhduar aplikimin e këtyre masave, pasi ka rëndësi për përmirësimin edhe të kornizës ligjore dhe tërheqjen e investimeve në vend.

Të gjashtë këto shtete u pajtuan gjithashtu që të kenë një udhërrëfyes për tregun rajonal të energjisë dhe transportit, kjo përmes integritetit të energjisë së ripërtitshme duke e lidhur kështu tregun rajonal me atë të BE-së.

Një prej samiteve më të rëndësishme në këtë drejtim konsiderohet edhe ai i Triestes, ku shtetet pjesëmarrëse ishin fokusuar në reformimin përveç të transportit edhe të energjisë, rritjen e mundësive për biznese dhe tërheqja e investimeve. Në këtë kontekst, ishte nënshkruar Traktati i Komunitetit të Transportit, me ç’rast edhe Kosova është nënshkruese e këtij traktati. Sipas ish-ministres, Justina Shiroka – Pulës, e cila kishte shërbyer gjatë qeverisjes së kryeministrit Isa Mustafa, nënshkrimi i këtij traktati nënkuptonte që Kosova duhet t’i përbëhet obligimeve nga direktivat e BE-së, të cilat synojnë një treg të qëndrueshëm.<sup>20</sup> Këtë deklaratë e kishte dhënë disa muaj pas takimit në Trieste.

Samiti i fundit, i mbajtur në Poznan rezultoi me pajtimin e pjesëmarrësve që të kompletohen masat e Reformës së Konektivitetit, duke krijuar kështu tregjet e energjisë brenda Ballkanit Perëndimor, e pastaj të integrohen në sistemin e brendshëm energjik të BE-së.

## **REKOMANDIMET PËR QEVERINË E RE**

Obligimet për sundim të ligjit dhe qeverisje të mirë janë përcjell në gati secilin samit, ku Kosova ka marrë shumë zotime të rëndësishme në këtë drejtim, përpos tjerave si bashkëpunimi rajonal dhe konektiviteti me rajonin. Vazhdimi i Procesit të Berlinit më së shumti i konvenon Kosovës edhe pse ka përfitime tejet të rëndësishme për përafrim të të gjithë rajonit me Bashkimin Evropian. Andaj, Qeveria e re e Kosovës duhet t'i jep një shtytje të re përmbushjes së obligimeve të marrura në këtë proces. Shumë nga rekomandimet e mëposhtme janë obligime që zyrtarët më të lartë të Kosovës vetëm i kanë marrë në Samitet e Procesit të Berlinit. Ne po i theksojmë ato më të rëndësishmet në fushën e sundimit të ligjit dhe mirëqeverisjes duke dhënë sugjerime shtesë për zbatueshmërinë e tyre në Kosovë. Qeveria e Re mund dhe duhet të marrë primatin e avancimit të mirëqeverisjes dhe forcimit të sundimit të ligjit dhe të shërbej edhe shembull për rajonin në Samitet e Agjendës “Berlin Plus”.

### **Përfshirja e zotimeve në program qeverisës**

Qeveria e re duhet të bëjë një analizë të të gjitha zotimeve të “Procesit të Berlinit” në mënyrë që t'i përfshijë në Programin Qeverisës i cili do të përpilohet për katër vitet e ardhshme. Kjo do të shërbente në raportimin e progresit të Kosovës në Samitet e ardhshme dhe Kosova të merret si partner më serioz nga udhëheqësit e lartë të BE-së

### **Një plan vjetor për zbatimin e zotimeve Anti-Korrupsion**

Po ashtu, Zyra e Kryeministrit duhet të përpilojë dhe mbikëqyrë plane vjetor për Zbatimin e Zotimeve Anti-Korrupsion të cilat i ka deklaruar Qeveria e Kosovës në Samitin e Londrës në 2018.

### **Reformimi i ligjit për prokurimin publik**

Në Proces të Berlinit, Qeveria e Kosovës së bashku me pesë vendet tjera të Ballkanit Perëndimor, është zotuar për implementimin e rreptë të dispozitave ligjore të Ligjit të Prokurimit Publik dhe akteve nënligjore të tij. Mirëpo në rastin e Kosovës, ky ligj duhet të reformohet duke adresuar mangësitë që janë shfaqur në të kaluarën, për të cilat ka mjaft studime në Kosovë. Reformimi duhet të bëhet jo vetëm për të parandaluar korrupsionin dhe rritur transparencën por edhe për të rritur efektshmërinë e prokurimit publik në Kosovë që ka paraqit mjaft sfida.

### **Stafi i Prokurimit Publik**

Edhe ky është një zotim që e ka marrë Qeveria e Kosovës në Procesin e Berlinit. Në Kosovë ka nevojë për profesionalizim dhe pavarësi të stafit të prokurimit në nivel lokal dhe qendror. Ka disa organizata lokale e donatorë të jashtëm që punojnë në profesionalizimin e këtij stafi por pavarësia mbetet më sfiduese.

### **Avancimi i e-Prokurimi**

Ky zotim në pjesën më të madhe është zbatuar pasi në Kosovë tashmë prokurimi elektronik është i obligueshëm, mirëpo ka hapësirë që ky sistem të avancohet që të thjeshtësohet dhe të ngritet më tutje transparenca. Kosova mund të bëhet shembull për Ballkanin Perëndimor në këtë fushë nëse punon në avancim të këtij sistemi mjaft të rëndësishëm.

## **Rekomandimet e Zyrës Kombëtare të Auditorit**

Qeveria e Re duhet të tregoj një vullnet të ri për të zbatuar rekomandimet e ZKA-së për institucione publike qendrore dhe lokale. Sidomos rekomandimet e ZKA-së për ministri në vitin 2018 dhe 2019 kanë dalë mjaft shqetësuese. Nëse zbatimi i rekomandimeve të ZKA-së nuk merr me vëmendje të shtuar të Qeverisë së Re, mund të kemi përkeqësim në këtë aspekt.

## **Financimi i Partive Politike**

Kosova duhet të ketë një Ligji për Financim të Partive Politike që siguron transparencë të plotë dhe funksionalitet të veprimtarisë legale të subjekteve politike. Ky legjislacion duhet të zbatohet në përpikëri duke instaluar dhe sanksione financiare të rrepta për mos-zbatim të këtij ligji. Përmirësimi i transparencës së financimit të partive politike me mekanizmat funksionues të sistemeve të kontrollit dhe auditimit. Ky zotim është marrë nga ‘Procesi i Berlinit’ dhe duhet të zbatohet jo vetëm për këtë qëllim por edhe për faktin se e ndalon korrupsionin përmes ‘blerjes së partive politike’ nga kontraktorë të qeverisë.

## **Aftësitë Hetuese të Administratës Tatimore të Kosovës (ATK-së)**

Krimi i organizuar lulëzon kur sistemi tatimor nuk është i aftë të formalizoj ekonominë joformale. Kosova është zotuar për forcimin e standardeve profesionale dhe aftësive të hetimit të Administratës Tatimore të Kosovës. Andaj, Kosova duhet të investoj edhe më tutje në ATK dhe sidomos në aftësitë hetuese të ATK-së. Kjo ndikon mirë edhe financiarisht për Kosovën.

## **Promovimi i Programit të Sinjalizuesit**

Sinjalizuesit janë mënyra më efektive për të identifikuar korrupsionin në institucione publike. Ligji për Sinjalizuesit duhet të zbatohet në përpikëri nga Qeveria e Re dhe duhet të ketë një fushatë promovuese që sinjalizuesit të raportojnë korrupsionin dhe të ketë shpërblime për stimulim të këtyre veprimeve.

## **Meritokracia në Administratë**

Reforma e Administratës Publike ka nisur mirëpo ende nuk ka arritur tek disa pjesë delikate siç është instalimi i plotë i meritokracisë në punësime dhe avancim të shërbyesve civil. Kjo është sfida e radhës në reformën e administratës dhe duhet të fillohet nga Qeveria e Re. Kjo çështje është potencuar dhe theksuar disa herë për vendet e Ballkanit Perëndimor në Samitet e Procesit të Berlinit.

## **Bashkëpunimi me Shoqërinë Civile në Proces të Berlinit**

Qeveria e re duhet të ketë një qasje të re sa i përket bashkëpunimit me shoqërinë civile për të ecur përpara në përafërimin drejtë Bashkimit Evropian dhe përmbushjen e zotimeve të dalura nga ‘Procesi i Berlinit’. Në samitet e një pas njëshme është zotuar promovimi dhe përfshirja e shoqërisë civile në politika dhe procese integruese. Forumi për Shoqëri Civile i formuar në Samitin e Vjenës përpos që nxit bashkëpunimin në mes të shoqërisë civile në vende të rajonit tonë, ai mund dhe duhet të shërbej për të ndihmuar qeverinë për të përparuar në këtë proces tejet të rëndësishëm.

